

KËRKESË

Kërkuese: **Shpresa Gani Beçaj**, Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë

Objekti: *Dorëheqje nga kërkesa për interesin e shprehur, për një vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë.*

Drejtuar: **KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

Tiranë

Të nderuar,

Unë, Shpresa Beçaj kam marrë njoftim në rrugë elektronike nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidaturës për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, për të cilën kam shprehur interes për kandidim.

Nëpërmjet kësaj kërkesë ju njoftoj se, heq dorë nga kërkesa për interesin e shprehur për arsyet si më poshtë:

Këtë interes e kam shprehur kohë më parë, në rrethanat e ndërprerjes së statusit të gjyqtarit për shkak të mosmarrjes në shqyrtim nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të kërkesës sime për t'u emëruar në Gjykatën e Apelit Tiranë, konform nenit 25 të Ligjit 8588 datë 15.03.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë".

Megjithëse kishte vende vakante në Gjykatën Kushtetuese, në momentin që kam mbaruar mandatin e gjyqtares dhe Kryetares së Gjykatës së Lartë, interesi im profesional dhe preferencat e mia ishin për të ushtruar detyrën e gjyqtares në organet e pushtetit gjyqësor.

Me vendimin e formës së prerë nr. 1434, datë 05.04.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, midis të tjerash është vendosur: "*Detyrimi i palës së paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë të nxjerrë aktin e emërimit të paditëses Shpresa Beçaj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.*" Ky vendim është ekzekutuar dhe më datën 04.06.2018 kam filluar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke u rehabilituar në statusin si gjyqtare karriere.

Për shkak të përvojës të gjatë në pushtetin gjyqësor dhe duke vlerësuar me ndërgjegje dhe përgjegjësi të lartë edhe situatën e krijuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të volumit të madh të punës, çmoj se kontributi im më i vlefshëm është të vazhdoj detyrën si gjyqtare pranë kësaj gjykate.

Duke ju uruar suksese në misionin tuaj të lartë, ju falenderoj për mirëkuptimin.

Me respekt dhe konsideratë të lartë

Kërkuese
Shpresa Beçaj

Tiranë datë 10.04.2019